



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 90 Prot

Tiranë, më 21.01.2022

V E N D I M

Nr.11, datë 21.01.2022

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të njësisë përgjegjëse, për moskthimin e nëpunësit *** , në pozicionin e mëparshëm të punës, Zv/Kryeinspektor në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, pas ndërprerjes së pezullimit dhe regjistrimin e tij në listë pritje.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet e ngritura nga nëpunësi ***** , në lidhje me mosrikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

VËREJ SE:

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së një kërkesë, të regjistruar me nr. 1051 prot, datë 25.11.2021, paraqitur nga nëpunësi ***** , konstatohet se ky nëpunës, i punësuar më parë në pozicionin e punës Zv/Kryeinspektor në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me dëshirën e tij, në Korrik të vitit 2021, ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil, për një periudhë një vjeçare, për shkak të punësimit në një aktivitet privat, e vërtetuar kjo me kontratën e punës, datë 05.07.2021, të lidhur me palë punëmarrës ***** dhe punëdhënës “Plexiglas Values” Shpk.

Kjo kërkesë është pranuar nga punëdhënësi dhe me urdhrin nr. 274 datë 06.07.2021, është vendosur pezullimi i tij duke shkëputur në të njëjtën kohë, marrëdhëniet financiare.

Pas kalimit të një periudhe prej disa muajsh, në fillim të muajit Tetor 2021, ai e ka ndërprerë punësimin në shoqërinë “Plexiglas Values” shpk, dhe ka kërkuar me shkrim, pranë njësisë përgjegjëse, të ndërpritet pezullimi dhe të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës.

Njësia përgjegjëse, ka kryer veprimet e nevojshme në përfundim të të cilave, ka konstatuar se kthimi i nëpunësit ***** në pozicionin e punës që kishte para pezullimit, “Zv/Kryeinspektor në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, ka qenë praktikisht i pamundur, për shkak se pozicioni i punës në fjalë ishte zënë rregullisht, pas kryerjes së procedurës së rregullt të konkurrimit (e nisur kjo për nevoja të domosdoshme të institucionit, me kërkesën nr. 1561/3, dt. 12.07.2021, të ISHPSHSH).

Nisur nga fakti i mësipërm, njësia përgjegjëse e ka njoftuar kërkuuesin se, në pamundësi për ta sistemuar menjëherë në një pozicion tjetër brenda shërbimit civil, të përshtatshëm me kategorinë dhe kualifikimin e tij, është regjistruar në listën përkatëse që mbahet nga Departamenti i Administratës Publike, deri në sistemimin e tij në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

Këtë qëndrim të njësisë përgjegjëse, nëpunësi në fjalë e ka konsideruar të paligjshëm, me pretendimin se pozicioni i punës është zënë padrejtësisht, pasi ai është kthyer brenda afatit 3-mujor, që parashikon pika 2, e nenit 56, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe për këtë ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke e kthyer në pozicionin e mëparshëm të punës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë procesit të verifikimit dhe analizës së rrethanave dhe veprimeve të kryera, arrihet në përfundimin se veprimet e njësisë përgjegjëse vlerësohen se janë kryer në përputhje me rregullat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të legjislacionit të shërbimit civil dhe në veçanti nenet 54, 55, e 56, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe të vendimit nr. 124 dt. 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

Në kushtet kur kërkesa e punonjësit në fjalë, për pezullim nga shërbimi civil është bërë për një afat një vjeçar dhe miratimi është dhënë për këtë afat, nuk kishte asnjë afat apo pengesë ligjore, si për institucionin ashtu dhe për njësinë përgjegjëse, që të kryenin veprimet e nevojshme, për plotësimin e pozicionit të punës “Zv/Kryeinspektor në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, që u lirua pas pezullimit.

Pretendimi i nëpunësit ***** se zënia e pozicionit të tij të punës është e paligjshme, pasi bazuar në pikën 2, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ai është

paraqitur në institucion dhe ka kërkuar ndërprerjen e pezullimit brenda afatit tremujor, gjë e cila prezumonte gjetjen e pozicionit të lirë të punës, nuk mund të merret në konsideratë.

Marrëveshja për pezullimin nga shërbimi civil të nëpunësit ******, është lidhur për një afat një vjeçar dhe në kushtet e mungesës së pengesave ligjore (*pasi, sipas pikës 2, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, vetëm kur pezullimi është kërkuar dhe miratuar për një afat deri në tre muaj, pozicioni i punës nuk mund të plotësohet deri në përfundim të pezullimit*) për nevoja të institucionit dhe ecurisë së punëve, institucioni, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me të drejtë, nëpërmjet shkresës nr. 1561/3 datë 12.07.2021, ka kërkuar prej njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, shpalljen e konkurrimit për plotësimin e pozicionit të punës “Zv/Kryeinspektor në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”.

Fakti që nëpunësi i pezulluar nuk e ka konsumuar gjithë periudhën e pezullimit të kërkuar/miratuar, nuk e ndryshon arsyetimin e mësipërm.

Nga gjithë sa më sipër, arrijmë në përfundimin që, njësia përgjegjëse ka vepruar në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil, si në rastin e plotësimit të pozicionit të mësipërm të punës nëpërmjet procedurës së konkurrimit, ashtu edhe në regjistrimin e nëpunësit ******, në listën e pritjes, deri në sistemimin e tij në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90/2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

- 1- Përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të njësisë përgjegjëse, për plotësimin nëpërmjet konkurrimit, të pozicionit të punës “Zv/Kryeinspektor në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore” dhe

moskthimin e nëpunësit ***** , në atë pozicion pas ndërprerjes së pezullimit, duke e regjistruar atë në listën e pritjes deri në sistemimin e tij në një pozicion të rregullt në shërbimin civil. Meqenëse në veprimet e mësipërme nuk konstatohen shkelje të legjislacionit të shërbimit civil çështja të arkivohet.

- 2- Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Tiranë, dhe *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha